

PAKETË UDHËZUESE PËR PEDAGOGËT PËR TRAJNIMIN E STUDENTËVE: FORMATI I DEBATIT

Formimi i skuadrave

Skuadrat formohen me 4 studentë secila.

Për realizimin e debatit nevojiten 2 skuadra.

Skuadrat duhet të kenë përfaqësi gjinore.

Skuadrat mund të kombinojnë pjesëmarrjen e studentëve BA, MA, MSH ose edhe doktoratë.

Anëtarët e skuadrës zgjedhin një lider.

Anëtarët e skuadrës punojnë ngushtë me njëri tjetrin dhe formojnë frymën e grupit.

Bashkëpunimi dhe komunikimi i vazhdueshëm është thelbësor për performancën e skuadrës.

Skuadra përgatitet së bashku për tematikat e debatit.

Pesha e përgatitjet nuk duhet të bjerë vetëm mbi liderin e skuadrës.

Rolet e anëtarëve të skuadrës përcaktohen që në fillim dhe pedagogu i asiston nëse ka nevojë.

Anëtarët ndajnë punën për përgatitjen e tematikave duke iu referuar paketës kërkimore dhe duke bërë kërkime të tjera të nevojshme përmes burimeve dytësore (biblioteka, burime online, burime nga pedagogu etj.). Pedagogu i lehtëson realizimin e këtij procesi kërkimor.

Skuadra afermativ është ajo që mban qendrimin pro dhe paraqet rezolutën pohuese i/e pari(a).

Skuadra opozitare ka për detyrë të kundërshtojë rezolutën apo tezën e paraqitur nga afermativi duke u bazuar në evidenca / argumenta dhe të ofrojë një tezë/rezolutë të tyre.

Rolet në skuadër

Lideri i skuadrës afermativ bën hapjen e debatit dhe paraqet rezolutën pro. Normalisht ky qendrim është i përgatitur më përpara për temat që studentët kanë paketat kërkimore.

Lideri i skuadër opozitare i kundërpërgjigjet rezolutës: së pari, nëse ka kundërshtim për termat apo konceptet e paraqitura; së dyti, nëse ka kundërshtim në parim me rezolutën; në treti, kundërshtim bazuar në argumenta dhe evidenca.

Lideri i skuadrës afermativ si edhe opozitar mund t'i përgjigjet pyetjeve që ngrenë folësit e skuadrës tjetër.



Lideri i skuadrës afermativ si edhe opozitar bëjnë përmbylljen e debatit përmes qendrimeve të tyre finale: së pari, afermativi dhe më pas opozitari.

Folësi II afermativ kundërpërgjigjet liderit opozitar, sqaron, thëllon argumentat e afermativit.

Folësi II opozitar kundërpërgjigjet, sqaron dhe thëllon argumentin e opozitarit.

Folësi i III ngre pyetje për skuadrën opozitare, bën koment kundërshtues nëse e nevojshme.


Folësi III ose lideri i skuadrës opozitare përgjigjet dhe ngre pyetje për skuadrën afermativ.

Folësi IV afermativ i përgjigjet pyetjeve, komente finale.

Folësi IV opozitar bën gjithashtu komente finale.

Të gjithë anëtarët e skuadrës duhet të flasin. Mund të zgjedh skuadra vetëm 3 folës dhe njëri anëtar të jetë mbështetës, por e rekomandueshme është të flasin të katërt.

Rrjedha e debatit me tematikat me përgatitje




Koha e debatit: 20 minuta



Debati i parë me tematikat me përgatitje zgjat 20 minuta. Debati i dytë me tematika të lira zgjat 10 minuta dhe peshën më të mëdha e mbajnë liderët dhe folësit II të të dyja skuadrave.

Rrjedha e debatit me tematika pa përgatitje



Ka tre gjykatës që mbajnë shënim pikët, komente dhe bëjnë vlerësimin.

Ka një moderator që u jep fjalën dhe mban orarin si edhe radhën / ndërhyr nëse skuadrat nuk zbatojnë etikën në komunikim apo thyejnë rregullat e debatit.

Vlerësimi i debatit

Kriteret për vlerësimin e debatit nga gjykatësit janë:

- aftësia argumentuese (paraqitja e argumentave, thellësia e argumentit, paraqitja e evidencave mbështetëse)
- Mendimi kritik / analiza kritike (reagimi i shpejtë me kundërgargumenta, shoqërimi me evidence, kundërpërgjigja)
- Aftësitë retorike dhe e folura në publik (aftësia për tu artikuluar, toni i zërit, postimi; aftësia për të bindur, stili i komunikimit)
- Etika në komunikim dhe ndërveprimi me kundërshtarët (shikimi në sy, mirësjellja, veshja, komunikimi verbal e jo verbal)

Si t'i përdorim pyetjet gjatë debatit



Përdorimi i pyetjeve përgjatë debatit ose cross-examination bëhet me qëllim që:

- skuadra qartëson pozicionin e skuadrës opozitare duke nxjerrë në pah dobësitë e tezës / rezolutës së tyre;
- skuadra i përdor pyetjet për të nxjerrë në hap vlerat e argumentit të vetë skuadrës;
- skuadra i përdor pyetjet për të vendosur kundërshtarin në pozita mendimi dhe analize që kërkon reagim të shpejtë.

Përdorimi i evidencave

Përdorimi i evidencave është shumë i rëndësishëm për të mbështetur argumentet dhe tezat që paraqesin skuadrat.

Evidencat duhet të jenë të sakta dhe me burime serioze dhe të verifikueshme.

Evidencat duhet të përdoren me ndershmëri dhe jo në mënyrë të njëanshme apo me interpretime të pasakta / të rreme.

Skuadra duhet të përdorë evidenca që janë në paketën e kërkimit dhe të bëjë kërkim të mëtejshëm për të pasuruar tezën.

Skuadra merr më pak pikë nëse përdor evidenca jo të sakta / nuk përdor evidenca.

Skuadra skualifikohet nëse i prodhon evidencat në mënyrë të rreme.

